

1. Me lidhjen e kësaj marrëveshjeje, mbajtësi i letërnjoftimit pranon të marrë pa pagesë nga ALEAT Sh.p.k. ("ALEAT") një Certifikatë Elektronike për Autentifikim dhe një Certifikatë të Kualifikuar për Nënshkrim Elektronik (së bashku referuar si "Certifikatat") me qëllim autentifikimin e mbajtësit të letërnjoftimit dhe përdorimin e Nënshkrimit Elektronik të Kualifikuar, në përputhje me ligjin dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje.
2. Certifikata për Nënshkrim Elektronik është një Certifikatë e Kualifikuar e lëshuar në përputhje me ligjin Nr. 9880, datë 25.02.2008 "Për nënshkrimin elektronik". Nënshkrimi elektronik i kualifikuar, në veprimet juridike dhe në aktet e tjera, ka të njëjtën vlefshmëri sikurse nënshkrimi me dorë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji. Përdorimi i Certifikatës së Kualifikuar dhe i nënshkrimit elektronik është vullnetar. Certifikatat dhe masat e sigurisë në lidhje me Certifikatën e Kualifikuar për Nënshkrimin Elektronik rregullohen sipas Politikave të Certifikimit, të publikuara në faqen e internetit [www.aleat.al](http://www.aleat.al).
3. Certifikatat duhet të përdoren VETËM me Platformën ALEAT, shërbimin e vulave kohore të ALEAT dhe VETËM me pajisjet të sigurta kriptografike të kualifikuara **dhe të pranuar** nga ALEAT, të listuara në faqen e internetit [www.aleat.al](http://www.aleat.al). Çdo nënshkrim elektronik i kualifikuar ose autentifikim në kundërshtim me këto kushte, do të jetë i pavlefshëm.
4. Mbajtësit të letërnjoftimit do t'i jepet një Kod PIN për autentifikimin dhe përdorimin e Nënshkrimit Elektronik të Kualifikuar, i cili duhet të ruhet i fshehtë. Mbajtësi i letërnjoftimit është në detyrë të faktit se nëse një person tjetër do të njohë dhe përdorë Kodin PIN, sëbashku me letërnjoftimin e mbajtësit të letërnjoftimit, ky person do të mund të autentifikohet dhe të nënshkruajë si mbajtësi i letërnjoftimit me një Nënshkrim Elektronik të Kualifikuar. Në asnjë rrethanë Kodi PIN nuk duhet të shkruhet apo të ruhet në të njëjtin vend me pajisjen e kualifikuar të pranuar nga ALEAT. Rivendosja e Kodit PIN, në rast se mbajtësi i letërnjoftimit e ka harruar ose humbur apo letërnjoftimi është bllokuar sepse Kodi PIN është vendosur 3 (tre) herë rradhazi në mënyrë të gabuar ose verifikimi i të dhënave biometrike të përdoruesit ka dështuar 5 (pesë) herë rradhazi bëhet pa pagese deri në vendosjen e një tarife të caktuar që do të publikohet në faqen e internetit [www.aleat.al](http://www.aleat.al) dhe në zyrat e aplikimit.
5. Mbajtësi i letërnjoftimit mund të shfuqizojë Certifikatat gjatë 24 orëve të ditës, 7 ditë në javë, duke telefonuar në numrin e telefonit të ALEAT për shfuqizimin ose duke u paraqitur pranë zyrave të aplikimit. Shfuqizimi i Certifikatave kryhet në momentin kur ky proces regjistrohet nga ALEAT dhe nuk ka efekt prapaveprues. Nëse mbajtësi i letërnjoftimit ka shfuqizuar Certifikatat, letërnjoftimi do të mbetet i vlefshëm, por Certifikatat e reja nuk mund të ngarkohen në këtë letërnjoftim. ALEAT i jep mbajtësit të letërnjoftimit një kod shfuqizimi, në mënyrë që të vërtetojë identitetin e tij pa nevojën e pranisë fizike të mbajtësit të letërnjoftimit. Ky kod duhet të ruhet i sigurt nga mbajtësi i letërnjoftimit, i cili është në detyrë të faktit se, nëse një person tjetër do të njohë këtë kod, atëherë ky i fundit mund të shfuqizojë Certifikatat nëpërmjet komunikimit telefonik në numrin e vendosur në dispozicion nga ALEAT.
6. Detyrimet e mbajtësit të letërnjoftimit
  - (a) Mbajtësi i letërnjoftimit nuk do të nënshkruajë asnjë dokument që përmban kode makro apo kode të ekzekutueshme që ndryshojnë përmbajtjen e dokumentit, të cilat do të eliminonin nënshkrimin elektronik të kualifikuar;
  - (b) Mbajtësi i letërnjoftimit do të përdorë çelës çift për nënshkrimin elektronik dhe autentifikimin;
  - (c) Mbajtësi i letërnjoftimit do t'a mbajë sekret Kodin PIN;
  - (d) Mbajtësi i letërnjoftimit do të tregojë kujdes të arsyeshëm për shmangien e përdorimit të paautorizuar të çelësave të tij privatë;
  - (e) Mbajtësi i letërnjoftimit do të njoftojë menjëherë ALEAT nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme ndodh gjatë periudhës së vlefshmërisë së Certifikatave:
    - (i) Letërnjoftimi ka humbur, është vjedhur, siguria dhe/ose integriteti i çelësave privatë është kompromentuar ose mbajtësi i letërnjoftimit ka harruar kodin PIN;
    - (ii) Kur mbajtësi i letërnjoftimit konstaton gabime në të dhënat e Certifikatave të lëshuara nga Aleat;
    - (iii) Kur mbajtësi i letërnjoftimit ndryshon të dhënat e përmbajtura në Certifikata.
  - (f) Përdorimi i një Certifikate të shfuqizuar është i ndaluar dhe çdo përdorim i paautorizuar do të ndiqet penalisht dhe/ose civilisht;
  - (g) Me marrjen e Certifikatave dhe të letërnjoftimit, mbajtësi i letërnjoftimit duhet të sigurohet për saktësinë e të dhënave në letërnjoftim dhe në Certifikata, duke refuzuar letërnjoftimin/Certifikatat në rast mospërputhje të dhënash;
  - (h) Nëse Certifikatat do të shfuqizohen apo bëhen të pavlefshme, mbajtësi i letërnjoftimit duhet të ndërpresë menjëherë përdorimin e tyre.
7. ALEAT do të shfuqizojë menjëherë Certifikatat kur (i) shfuqizohet letërnjoftimi (ii) mbajtësi i letërnjoftimit kërkon shfuqizimin e Certifikatave (iii) Certifikatat janë lëshuar në bazë të dhënash të rreme (iv) ALEAT ndërpret aktivitetin dhe ky aktivitet nuk iu transferohet subjekteve të tjera që ofrojnë shërbime autentifikimi dhe certifikimi (v) Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike ose autoritete të tjera publike kompetente urdhërojnë shfuqizimin e Certifikatave.
8. Mosmarrëveshjet e mundshme midis palëve do të zgjidhen me mirëkuptim ose duke e paraqitur mosmarrëveshjen pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. Në rast se mosmarrëveshja nuk do të zgjidhet ndërmjet palëve, ajo do të gjykohej përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
9. Trajtimi i të dhënave personale të mbajtësit të letërnjoftimit do të bëhet në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve të tjera ligjore në fuqi, në masën e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të autentifikimit dhe të nënshkrimit elektronik të kualifikuar. Kjo marrëveshje do të ruhet dhe do të arkivohet (e nënshkruar në letër ose elektronikisht) për 10 vite dhe regjistrat e ngjarjeve që lidhen me ciklin e vlefshmërisë së Certifikatave (përfshirë çelësat e gjeneruar të ngjarjeve) për 20 vjet, në respektim të standardeve eIDAS/ETSI.
10. Përdorimi i certifikatave dhe i nënshkrimit elektronik të kualifikuar, apo identifikimit elektronik të sigurt, në përputhje me ligjin dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje, është detyrim dhe përgjegjësi e mbajtësit të letërnjoftimit. ALEAT nuk është përgjegjës për dëme shkaktuar mbajtësit të letërnjoftimit ose palëve të treta, përfshirë këtu palët që ndikohen nga ky përdorim, nga keqpërdorimi i certifikatave dhe nënshkrimit elektronik të kualifikuar, nga mbajtësi i letërnjoftimit apo nga personat e tretë. Garancitë financiare për shpërblimin e dëmeve nga ALEAT, në rast shkelje të ligjit apo nga mosfunksionimi i duhur i produkteve dhe/ose shërbimeve, kufizohen në shumat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
11. Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji shqiptar dhe do të jetë në fuqi deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë apo shfuqizimin e Certifikatave.

**Unë e kam lexuar dhe kuptuar këtë marrëveshje dhe duke e nënshkruar atë, jam dakort dhe pajtohem me kushtet e përdorimit**

Data dhe vendi	Nënshkrimi (Emri, mbiemri dhe firma)
----------------	--------------------------------------